



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 12.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik GUXO

- I. Subjektit politik GUXO, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik GUXO, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Subjekti politik obligohet që në pasqyrat financiare për vitin 2024, të cilat dorëzohen jo më vonë se data 01.03.2025, t'i paraqes dëshmitë për shfrytëzimin e zyrave, që përfshinë selinë qendrore dhe degët nëpër komuna, nëse kanë.
- IV. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.
- V. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme

Arsyetim

Subjekti politike GUXO, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 09.03.2022.

Subjekteve politike të regjistruara u kërkohet që të kenë një adresë të selisë, të cilën e deklarojnë përmes Azhurnimeve vjetore, ku kërkohet adresa e selisë së partisë.

Në përputhje me nenin 15 të LFSP ku theksohet qartë se, raporti vjetor financiar i subjektit politik të regjistruar duhet të përmbajë të dhënat për të gjitha shpenzimet si dhe regjistrin e të gjitha kontributeve për subjektin e regjistruar politik.

Subjekti politik edhe pse ka raportuar që nuk ka pas asnjë shpenzim e as të hyrë, gjatë vitit 2023, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Zyrë, konstatohet se subjekti politik ka shfrytëzuar

një lokal si zyrë për selinë qendrore gjatë vitit 2023, por të njëjtin nuk e ka pasqyruar si të hyrë nga kontributi në natyrë, në mallra dhe shërbime, por as si shpenzim nga qiraja.

Mos pasqyrimi i shpenzimeve apo kontributeve të subjektit politik paraqet shkelje të nenit 15 të LFSP dhe si rezultat, kjo shkelje gjohet në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik GUXO, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Paga e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë.

Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 12.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik GUXO.
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik GUXO.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.